

KONTRATA
E SHITJES SË KUOTËS

Sot më datë 31/12/ 2019, lidhet kjo kontratë ndërmjet palëve të mëposhtme:

NEP Investment Corp., një shoqëri e kufizuar nga aksionet e regjistruar në Ishujt Kajman, me numër regjistrimi 152503 dhe me seli në M&C Corporate Services Limited, PO Box 309GT, Ugland House, South Church Street, George Town, Grad Cayman, Ishujt Kajman, përfaqësuar nga Vilsa Lika, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë në 1972, mbajtëse e kartës së identitetit nr. 029365555, me nr. personal H25606056M e autorizuar me Prokuren e dates 15 Janar 2019.(Këtu e më poshtë referuar si **Shitësi**)

dhe

ARTAN DULAKU (AD), shtetas shqiptar, lindur më 30.05.1965, mbajtës i kartës së identitetit me numër 028592335 dhe nr. Personal G50530166T. (Këtu e më poshtë referuar si **Blerësi**)

Palët e mësipërme kanë rënë dakort që të lidhin këtë marrëveshje të shitjes së kuotave me afatet dhe kushtet e mëposhtme:

DUKE PATUR PARASYSH QË,


- A.** Iliria Development sh.p.k. është një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar në Shqipëri, me NUIS K72208033U, me seli në "Sky Tower, Kati 7, Tiranë, Shqipëri", ("Kompania"). Ortakë të Kompanisë janë NEP Investment Corp. dhe Artan Dulaku.
- B.** Shitësi zotëron 51% të kapitalit të Kompanisë, që korresponon me një kuotë me vlerë prej Euro 2'040'000.
- C.** Blerësi zotëron 49% të kapitalit të Kompanisë, që korresponon me një kuotë me vlerë prej Euro 1'960'000.
- D.** Palët kanë rënë dakord, me anë të një marrëveshje mes tyre, që Artan Dulaku, në pozitën e blerësit, do të blejë kuotën e ortakut tjetër, NEP Investment Corp., në pozitën e shitësit. Si pasojë, pas këtij veprimi, me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Artan Dulaku do të jetë ortaku i vetëm i Shoqërisë "Iliria Development" sh.p.k.

Neni 1 – Baza Ligjore

Shitësi dhe Blerësi lidhin këtë marrëveshje në bazë të Rezolutës me Shkrim të Aksionerëve të Asamblesë së Shoqërisë "Iliria Development" sh.p.k. dhe Ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të cilët vendosën aprovimin e kalimit/transfertës së kuotës së shitësit nga ky i fundit te blerësi, nëpërmjet shitjes, ashtu siç përshkruhet në këtë Kontratë.

Neni 2 - Qëllimi

Shitësi, në datën e kësaj Kontrate (Data Efektive) pranon t'i kalojë/transferojë, nëpërmjet shitjes, Blerësit, kuotën që ai zotëron në Shoqërinë "Iliria Development" sh.p.k., që korrespondojnë me 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit të kësaj Shoqërie, kurse Blerësi pranon të blejë kuotën e shitësit.





Neni 3 – Të drejtat dhe detyrimet e palëve

Shitësi i garanton Blerësin që kuotat, subjekt i kësaj kontrate janë të transferueshme dhe të lira e pa asnjë barrë hipotekore në datën efektive.

Neni 4 – Cmimi dhe metoda e pagesës

Palët kanë rënë dakort që shitësi të transferojnë kuotën e tij në Shoqërinë “Iliria Development” sh.p.k. te blerësi, me një çmim total prej 2’100’000 (dy million dhe njëqind mijë) Euro. Kjo vlerë është paguar totalisht nga blerësi në favor të shitësit.

Neni 5 – Pronësia dhe data e hyrjes në fuqi

Asambleja e ortakëve të Shoqërisë “Iliria Development” sh.p.k. e ka aprovuar këtë Marrëveshje të Shitjes së Kuotave nëpërmjet Vendimit me Shkrim të Aksionerëve të Asamblesë. Kjo kontratë merr fuqi ligjore me nënshkrimin e saj dhe do të jetë subjekt regjistrimi në Regjistrin Tregtar menjëherë pas nënshkrimit nga palët

Pas nënshkrimit të kësaj Kontrate, Blerësi Artan Dulaku do të jetë Ortaku i Vetëm i Shoqërisë “Iliria Development” sh.p.k., dhe do të njoftojnë Qendrën Kombëtare të Biznesit për të pasqyruar ndryshimet në pronësinë e Shoqërisë. NEP Investment Corp. pranon se zhvishet nga pronësia e pjesës së saj takuese në Shoqërinë “Iliria Development” sh.p.k. dhe nuk ka asnjë arsye për të pretenduar të kundërtën, as tani, as në të ardhmen.

Kjo Kontratë rregullohet nga ligji shqiptar. Në rast mosmarrëveshjeje mes palëve, kompetente është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kontrata është e përbërë në 5 (pesë) kopje në gjuhën Shqipe dhe kanë të njëjtën vlerë ligjore.

SHITËSI

Për NEP Investment Corp

Vilsa LIKA



BLERËSI

Artan DULAKU



Vërtetim Nënshkrimi

Në Tiranë, sot më datë 31 Dhjetor (dymijë e nentëmbëdhjetë), përpara meje noteres **MARIANA DAKA**, Anëtare e Dhomës së Noterëve Tiranë, pajisur me NIPT L42125011B, jashtë zyrës noteriale u paraqitën personalisht:

- "NEP INVESTMENT CORP."**, një shoqëri e regjistruar ligjërisht sipas ligjeve të Ishujve Kayman, i regjistruar në Regjistrin Tregtar të Ishujve Kayman me numër regjistrimi MC-152503, me seli në adresën P.O. BOX 309, Ugland House, South Church Street, George Toën, Grad Cayman KY1-1104, Ishujt Kayman, përfaqësuar nga Përfaqësuesja **Zj.Vilsa Lika**, e datëlindjes 06 Qershor 1972, lindur në Tiranë, shtetase shqiptare, banuese në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e Letërnjoftimit me numër 029365555 dhe me numër personal H25606056M, dhe
- Z. Artan DULAKU**, atësia Niko dhe amësia Lirika, i datëlindjes 30 Maj 1965, lindur në Tiranë, shtetas shqiptar, banues në adresën: Kompleksi i Vilave, Sauk, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me numër 028592335 dhe numër personal G50530166T, me datë lëshimi 09.03.2010, autoritet lëshues MB.

të cilët më deklaruan se sa më sipër është një **"Kontrate e Shitjes Se Kuotave"**, datë **31.12.2019**, i hartuar dhe i nënshkruar prej tyre personalisht, në gjuhën Shqipe, dhe unë, Noterja i vërtetoj nënshkrimet e tyre rregullisht sipas nenit 55, të Ligjit Nr. 7829, datë 01.06.1994, "Për Noterinë".

NOTERE
Mariana Daka